



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program Studime evropiane (2013/2014)

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Titulli	I diplomuar për studime evropiane
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-254/5
Data akreditimit	10.04.2013

Përshkrimi i programit

Programi studimor *studime evropiane* nga cikli i parë dhe cikli i dytë i studimeve do t'i kualifikojë studentët për punë të pavarur dhe analitike profesionale në fushën e çështjeve evropiane në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-se. Programi, në të dy ciklet, integron disa disiplina të *studimeve evropiane*: shkenca politike (në veçanti marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikat krahasimtare), ekonomi, drejtësi, shkenca shoqërore (me theks të veçantë në aftësitë metodologjike) dhe komunikim (duke theksuar rëndësinë e dy gjuhëve të huaja) me zbatimin e tyre në çështjet qendrore të integritetit evropian (BE) dhe të ndërtimit më të gjerë të Evropës. Të dy programet janë të ndërlidhura, por ato mund të studiohen edhe si të pavarur, sepse janë konceptuar si tërësi si të mëvetësishme.

Karriera

Studimet deridiplomike i përgatisin studentët për studimet e magjistraturës në *studime evropiane*. Gjithashtu i përgatisin ata për punësim në institucionet e BE-së dhe në organizatat tjera ndërkombëtare (evropiane), në nivel kombëtar, në veçanti në ministritë e punëve të jashtme, në ministritë për çështjet evropiane, ministrinë për zhvillim ekonomik dhe social; mundësi të punësimit janë gjithashtu edhe institucionet në nivel rajonal (nga komunat dhe qytetet), OJQ-të, mediat dhe partitë politike, ekspertiza në fushën e proceseve të BE-së dhe politikat. Gjithashtu, tregu i brendshëm i punës bën të diplomuarit adekuat për sektorin e biznesit brenda dhe jashtë BE-së.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Tregon njohuri themelore dhe të kuptuarit për fushën shkencore të hulumtimit (ose studimit), duke identifikuar metodologji përkatëse për zgjidhjen e problemeve, si në mënyrë sistematike ashtu edhe në mënyrë kreative, gjë që ofron një bazë ose një mundësi për origjinalitet në zhvillimin dhe/ ose aplikimin e ideve autonome në kontekst të kërkimit;
- Aftësi për identifikimin e njohurive të zgjeruara dhe të thelluara;
- Tregon nivel njohurish dhe kompetencë në një apo më shumë fusha të veçanta shkencore;
- Ka njohuri të një apo të më shumë lëmenj, të cilat, në fushat e caktuara shkencore, bazohen në hulumtimet me më renome të hulumtimeve ndërkombëtare shkencore në këtë fushë shkencore.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Aftësi për zgjidhje kritike, të pavarur dhe krijuese të problemeve me një origjinalitet të caktuar në mjedise të reja ose dhe në kontekst multidisiplinar lidhur me fushën e studimit.

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi sintetizimin dhe integrimin e njohurisë;
- Aftësi për t'u përballur me çështjet, sistematikisht dhe në mënyrë krijuese, për një vlerësim solid, madje edhe kur informacionet janë jo të plota ose të kufizuara, por të cilat i përfshijnë përgjegjësitë personale, sociale dhe etike në zbatimin e njohurive të fituara dhe të vlerësimit;
- Aftësi për identifikimin dhe përzgjedhjen e teorive shkencore, të metodologjive, mjeteve dhe shkathtësitë të përgjithshme nga fushëveprimi i lëndëve dhe iniciimi i analizave dhe zgjidhjeve të reja në baza shkencore.

Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për këmbimin e konkluzioneve dhe propozimeve me argumentim dhe me mbështetje racionale të tyre, si me persona profesionistë ashtu edhe me joprofesionistë, qartazi dhe paluhatshëm;
- Marrja e përgjegjësisë së konsiderueshme për rezultatet e përbashkëta; drejtimin dhe iniciimin e aktiviteteve.

Aftësitë e të mësuarit

- Aftësi për njohjen e nevojave personale për dituri të mëtejshme edhe aftësi për veprim të pavarur dhe të mëvetësishëm gjatë fitimit të diturive dhe aftësive dhe shkathtësive të reja në korniza shoqërore;
- Aftësi për marrjen e përgjegjësisë për zhvillim dhe përkryerje profesionale të mëtejshme

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [6.0 SETK] **Hyrje në shkencat politike**
- [6.0 SETK] **Hyrje në sistemet politike**
- [9.0 SETK] **Hyrje në BE**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 1**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - gjuhë e huaj 1**

Semestri 2

- [9.0 SETK] **Bazat e marrëdhënieve ndërkombëtare**
- [6.0 SETK] **Ekonomia e integrimit evropian**
- [6.0 SETK] **Statistikë**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 2**
- [3.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - gjuhë e huaj 2**

Semestri 3

- [9.0 SETK] **Hyrje në të drejtën e BE**
- [6.0 SETK] **Ekonomia politike në BE**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - gjuhë e huaj 3**
- [3.0 SETK] **Gjuhë e huaj profesionale 1**

Semestri 4

- [9.0 SETK] **Hartimi i politikave në BE**
- [6.0 SETK] **Metodat sasiore në shkencat shoqërore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë 3**
- [3.0 SETK] **Gjuhë e huaj profesionale 2**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore - gjuhë e huaj 4**

Semestri 5

- [9.0 SETK] **Mbrojtja evropiane e të drejtave të njeriut**
- [9.0 SETK] **Shkrimi i seminarit**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 2**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 3**

Semestri 6

- [6.0 SETK] **Veprimi i jashtëm i BE-së**
- [6.0 SETK] **Shkrimi i seminarit – i avancuar**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 4**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 5**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore 6**

Description of courses

Lëndë obligative

• Hyrje në shkencat politike

Ky kurs i njofton studentët me konceptet qendrore dhe me idetë e metodat teorike të shkencës bashkëkohore politike dhe pastaj i zbaton në modelet e sjelljes politike, në institucionet politike, si dhe në politikat publike. Kursi studion konceptin e politikës, pushtetit, qeverisë, sistemeve dhe regjimeve, shtetit dhe demokracisë, ideologjisë politike, kulturës politike, identitetit dhe identifikimit, partive dhe partive e sistemeve, masmediave dhe komunikimit politik, institucioneve politike dhe politikave publike. Në fund të lëndës studentët duhet ta kuptojnë konceptin e politikës dhe të politikave, t'i shpjegojnë modelet e dizajnit institucional të shtetit, qeverisë dhe demokracisë, në mënyrë kritike ta vlerësojnë vendosjen dhe lëshimin rrënjë në kulturë dhe në raportet me mediat, t'i kuptojnë proceset dhe dizajnin politik të sjelljes së vendimeve.

• Hyrje në sistemet politike

Hyrje në sistemin politik, rëndësia dhe klasifikimi i sistemeve politike, roli, vendi dhe funksionimi i sistemit politik të Republikës Socialiste të Maqedonisë në kuadër të RSFJ-së, kriza politike e RSFJ-së dhe mëvetësimi i Republikës së Maqedonisë, si një shtet i pavarur, funksionimi, formimi i sistemit politik të Republikës së Maqedonisë në vlerat e pluralizmit politik dhe të demokracisë liberale, tiparet themelore të rregullimit parlamentar në Republikën e Maqedonisë, vendi dhe roli i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në sistemin politik të Republikës, roli i qeverisë në sistemin politik të Republikës, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, pushteti gjyqësor në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë, pushteti lokal në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë, partitë dhe sistemi partiak, zgjedhjet dhe sistemi elektoral në Republikën e Maqedonisë, roli dhe vendi i grupeve të interesit në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë, marrëdhëniet ndëretnike, konflikti i armatosur dhe nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, funksionimi i sistemit politik të Republikës së Maqedonisë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, perspektiva, evropianizimi i Republikës së Maqedonisë, sistemi politik i Republikës së Maqedonisë dhe globalizimi.

• Hyrje në BE

BE-ja si një organizatë rajonale ndërkombëtare joqeveritare dhe / ose një sistem politik, me çka një entitet sui generis ; por edhe roli i integritetit ndërqeveritar. Pasqyrë e eksperimenteve dhe ideve të bashkëpunimit dhe integritetit evropian (Perëndimor) pas Luftës së Dytë botërore dhe vendosja e BE-së në këto procese. Perspektiva historike: Shfaqja dhe zhvillimi i komuniteteve evropiane dhe i BE-së. Nga ideja fillestare për thellim (sektoriale) dhe për zgjerim (territoriale). Platforma e integritetit ekonomik (fazat e integritetit ekonomik). Marrëveshja kornizë: marrëveshjet themelore të komuniteteve evropiane dhe të BE-së, marrëdhëniet ndërmjet tyre, rolet, struktura, organizimi dhe puna. Roli dhe rëndësia e subjekteve të tjera relevante në BE. Procesi politik: vendosja e agjendës dhe formulimi, sjellja e vendimeve dhe zbatimi i ligjit në BE. Ligji BE: diversiteti i BE-së i akteve ligjore të saj, natyra e tyre, kontrolli i zbatimit, Gjykata e drejtësisë së BE-së. Politikat e BE: politikat interne (rregullatore / redistributive), veprimi i jashtëm i BE-së (BE për marrëdhëniet e jashtme dhe politikën e jashtme).

• Bazat e marrëdhënieve ndërkombëtare

Përkufizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, si një fenomen, karakteristikat e bashkësisë ndërkombëtare (IC), evoluimi bashkëkohor (Westphalian) i IC, sistemit të baraspeshës së forcës me kalimin e kohës, Lidhja e Kombeve,

mjetet për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve, Kombet e Bashkuara (parimet, objektivat, dhe organet dhe siguria kolektive), në fund të Luftës së ftohtë bipolarism (KSBE, OSBE), Struktura e IC - tri qasjet e mirëkuptimit të IC, faktorët dhe subjektet e marrëdhënieve ndërkombëtare; politika e jashtme e shteteve; organizatat ndërkombëtare dhe subjektet tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare, proceset dhe marrëdhëniet në IC, rëndësia e normave ndërkombëtare dhe evoluimi i së drejtës ndërkombëtare në dritën e luftës kundër terrorizmit dhe sigurisë njerëzore, roli dhe rëndësia e bërjes së kuptimit të teorisë në marrëdhënie ndërkombëtare, si shkencë dhe evolucioni i këtyre të fundit.

- **Ekonomia e integritit evropian**

Lënda siguron një pasqyrë të teorive, institucioneve, politikave, dhe analizave empirike të cilat janë të nevojshme për të kuptuar parimet ekonomike të integritit evropian. Ekonomia evropiane përfshin dy aspekte mikroekonomike dhe makroekonomike të integritit ekonomik (liberalizimi preferencial, madhësia e tregut dhe efektet, e vëllimit, efektet e rritjes dhe faktorët e integritit të tregut), si dhe zgjedhja e politikave kyçe të BE.

- **Statistikë**

Qëllimi i këtij kursi është që t'i njoftojë studentët me elementet e statistikave përshkruese të cilat janë drejtuar kah grumbullimi, përpunimi dhe shfaqja e të dhënave, interpretimi i tyre cilësor, sjellja e konkluzioneve dhe formimi i ligjshmërive për sjelljen e dukurive të vëzhguara. Në mënyrë plotësuese do të mund ta shfrytëzojnë statistikën si një bazë për sjelljen e vendimeve dhe si udhërrëfyes për zbulimin e lidhjeve midis të dhënave.

- **Hyrje në të drejtën e BE**

Pjesa e parë e kësaj lënde merret me forma të bazuara në jurisprudencë ku studentët do të njoftohen me konceptin e ligjit dhe të shtetit, me, konceptet themelore juridike, me karakteristikat e ligjit moderne dhe me marrëdhëniet në mes të drejtës dhe politikës. Pjesa e dytë paraqet një disiplinë të veçantë ligjore, me një fjalë, me disiplinën kushtetuese, me ato penale, realisht ka të bëjë me marrëdhëniet detyruese, me ato komerciale, me laboratorin, familjen dhe të drejtën e trashëgimisë dhe të drejtën e BE-së e të administratës publike. Qëllimi i pjesës së tretë të lëndës është të prezantojë fushat themelore ligjore që i përfshin e drejta e BE-së, instrumentet kryesore ligjore të BE-së dhe institucionet ligjore për të siguruar zbatimin e *acquis-it* në shtetet anëtare. Përveç kësaj, qëllimi është që të nxjerrë në pah procedurat për miratimin e drejtësisë evropiane, dhe analiza aktuale, rëndësia dhe procedura e miratimit të së drejtës së të drejtës evropiane në proceset e integritit evropian.

- **Ekonomia politike në BE**

Kursi merret me strukturën e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare politike dhe ekonomike me vëmendje të veçantë ndaj atyre që janë relevante për procesin e integritit evropian. Qëllimi është të prezantohen dhe të analizohen marrëdhëniet interaktive midis politikës dhe ekonomisë në bashkësinë bashkëkohore ndërkombëtare, veçmas rëndësia e faktorëve ekonomikë dhe roli i subjekteve individuale në marrëdhëniet ndërkombëtare (jo vetëm vendet, por gjithnjë e më shumë kompani shumëkombëshe, organizata qeveritare dhe jo-qeveritare).

- **Hartimi i politikave në BE**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve ta përkufizojnë dhe ta ilustrojnë analizën politikave dhe rolin e tyre në politikëbërjen e BE-së. Nuk ka ndonjë pajtim për mënyrën se si pikërisht të përkufizohet politika publike. Studentët do të kenë mundësi të njoftohen, me këtë fushë dhe ta analizojnë në mënyrë kritike zhvillimin, por dhe dukuritë në fushën e politikave publike. Krijimi dhe analiza e politikave publike është një disiplinë për zgjidhjen e problemeve që tërheq njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave shoqërore dhe të filozofisë së politikave.

- **Metodat sasiore në shkencat shoqërore**

Kursi i përpunon perspektivat dhe metodologjitë e ndryshme epistemologjike lidhur me qasjet e ndryshme. Lënda, gjithashtu përfshin punën me teknikat e shkrimit akademik dhe mënyrën se si të hartohet dhe si të shkruhet një punim akademik. Në këtë lëndë Lënda përfshihet një pasqyrë e metodave themelore në shkencat shoqërore (metodat statistikore, teknikat e intervistimit, analiza e përmbajtjes dhe vëzhgimi).

- **Mbrojtja evropiane e të drejtave të njeriut**

Kursi trajton çështjet e mbrojtjes evropiane të të drejtave të njeriut në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë. Në kuptimin e ngushtë, kujdes i veçantë u kushtohet institucioneve ndërkombëtare siç është Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Në një kuptim më të gjerë, do të analizojë mbrojtjen evropiane të të drejtave të njeriut qëka të bëjë me një proces të gjatë një dekenie të demokratizimit në Evropë. Korniza e përgjithshme e lëndës plotësohet me studimet e rasteve dhe me çështje të hapura.

- **Shkrimi i seminarit**

Qëllimi i lëndës është që studentët t'i përgatisë të shkruajnë analiza shkencore e profesionale sidomos ese dhe punime seminarike, studentët t'i zhvillojnë shkathtësitë për kërkimin dhe identifikimin e burimeve të ndryshme të hulumtimeve shkencore, të shkruajnë dhe të prezantojnë dokumente shkencore dhe të krijojnë tekste shkencore duke i shfrytëzuar metodat themelore të hulumtimeve shkencore shoqërore. Qëllimi i dytë është që të zhvillojë aftësitë kërkimore dhe aftësinë analitike për të sintetizuar gjetjet shkencore. Qëllimi i tretë është aftësimi i tyre të interpretojnë dhe të shfrytëzojnë burime primare dhe sekondare, sidomos për studime evropiane si një fushë shkencore. Një pjesë më e vogël e lëndës i kushtohet shkathtësisë së komunikimit gojor.

- **Veprimi i jashtëm i BE-së**

Lënda i njofton studentët me aspektet teorike të të kuptuarit të marrëdhënieve të jashtme të BE si një lëmi e veçantë e agjencisë së BE-së me elementet e Politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët ("politika e lartë") dhe ish komisioner përmarrëdhënie të jashtme dhe marrësh[nie të jashtme ekonomike dhe zhvillon një politikën dhe dimensionet e policisë së brendshme ('politika ulët'). Të dy fenomenet janë shpjeguar nga analizat procedurale (politikë-vendime) dhe analiza qenësore materiale (arena vertikale dhe horizontale të veprimit të jashtëm). Baza teorike e kursit është të kuptuarit social konstruktivist të BE-së si një aktor global përmes koncepteve dhe aftësive, mundësive dhe pranisë. Shfrytëzimi i studimeve në thellësi të rastit të kursit siguron njohuri se si dhe në çfarë kushtesh dhe në cilën BE politikë, BE-ja mund të kryejë në mënyrë aktive qëllimet e veta politike apo fitime nga prania në bashkësinë ndërkombëtare. Areans vertikale e veprimit të jashtëm të BE-së janë: tregtia e jashtme, zhvillimi, mjedisi, energjia, bujqësia, drejtësia, punët në shtëpi, politika e zgjerimit të BE-së, politikat e BE dhe interregjionalizmi. Arenat vertikale kushtojnë vëmendje të veçantë marrëdhënieve me BE: Ballkani Perëndimor, rajoni i Mesdheut dhe Lindje- vendet evropiane, Deti e Zi dhe SHBA.

- **Shkrimi i seminarit – i avancuar**

Qëllimi i lëndës është që studentët të përgatiten për të shkruar analizë shkencore e profesionale e sidomos ese dhe punime seminarike, të zhvillojnë aftësitë për kërkimin dhe identifikimin e burimeve të ndryshme të kërkimit shkencor, shkrim dhe prezantim të dokumenteve shkencore dhe formim të teksteve shkencore duke përdorur metodat themelore të hulumtimeve shkencore shoqërore. Qëllimi i dytë është që të zhvillohen aftësitë kërkimore dhe aftësitë analitike për të sintetizuar gjetjet shkencore. Qëllimi i tretë është aftësimi i tyre që të interpretojnë dhe të shfrytëzojnë burime primare dhe sekondare, sidomos për studimet evropiane si një fushë shkencore. Një pjesë e vogël e lëndës është e përkushtuar në shkathtësitë e komunikimit gojor.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 1**

Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 1 është e caktuar për studentë të cilët kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze. Lënda ka për qëllim t'i avancojë edhe më tej katër shkathtësitë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Temat dhe terminologjia që do të përpunohen në këtë lëndë janë të lidhura me terminologjinë specifike të Bashkimit Evropian dhe të institucioneve të tij.

- **Gjuhë gjermane 1**

Lënda i njofton studentët me strukturat themelore të gjuhës gjermane. Pjesëmarrësit do t'i zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit në lexim, në dëgjim, në të folur dhe në të shkruar. Kursi do t'i aftësojë ata të realizojnë biseda të thjeshta nga jeta e përditshme gjatë shitblerjes ose në restorant dhe të flasin drejtpërdrejt për të kaluarën. Ata do të njoftohen me strategjitë për dëgjim me të kuptuar dhe mund të përfitojnë informacione nga fusha e kulturës dhe civilizimit nga leximi i teksteve të thjeshta. Përveç asaj do të ushtrohen edhe veçoritë fonetike në kontekste komunikuese.

- **Institucionet evropiane**

Objekti kryesor i kësaj lënde është që studentët të zhvillojnë aftësitë për analizë, për të kuptuar dhe për të vlerësuar objektivist përzierjen komplekse të fenomeneve që përbëjnë integrimin dhe politikën evropiane. Qëllimi i këtij kursi është që t'u mundësojë studentëve t'i analizojnë politikat e Bashkimit Evropian, t'i përshkruajnë karakteristikat e tyre kryesore. Kursi shqyrton zhvillimin e institucioneve të BE-së, vendimmarrjen dhe rolin e aktorëve kryesorë. Përshkruan dhe shpjegon të gjitha fazat e zhvillimit të institucioneve të BE-së, shpjegon funksionimin e këtyre institucioneve, analizon kontributin e tyre në politikën evropiane përmes vendimmarrjes.

- **Politika sociale evropiane**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentëve në studimet evropiane t'u ofrojë një shans ta mësojnë bazën teorike të ngjarjeve dhe të debateve aktuale rreth politikës sociale evropiane. Kursi fokusohet dhe problematizon politikën sociale evropiane, rregullimin e institucioneve me akte, debatet rreth çështjeve sociale etj.

- **Hyrje në të drejtën ndërkombëtare**

Studentët mësojnë për marrëdhëniet në bashkësinë ndërkombëtare të rregulluara me norma. Kështu, ata studiojnë faktin se si këto marrëdhënie duhet të jenë. Ata mësojnë për me burimet e së drejtës ndërkombëtare, për subjektet e së drejtës ndërkombëtare nga ana e shtetit drejt individit, të autoriteteve përgjegjëse për veprim në komunitetin ndërkombëtar, elementet themelore të shtetësisë, të drejtat dhe detyrimet e shteteve, si dhe të individëve, për sistemin e sigurisë kolektive dhe mjetet e zgjidhjes paqësore të kontesteve. Kursi fokusohet në studimin e rasteve të veçanta ligjore. Tema do të trajtohet përmes qasjes së shkencave sociologjike dhe politike, analizave të trendeve dhe të rregullave të rendit të ndërkombëtar.

- **Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 2**

Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 2 është e përgatitur për studentët të cilët e kanë kryer me sukses lëndën gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 1. Është përpiluar për t'i avancuar dhe më tej njohuritë e gjuhës angleze. Temat dhe terminologjia që do të përpunohen në këtë lëndë janë të lidhura me agjencitë dhe trupat tjerë të Bashkimit Evropian.

- **Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 3**

Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 3 është e dizajnuar për studentët të cilët e kanë kryer me sukses lëndën gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 2. Duke marrë parasysh se ky është niveli më i avancuar i gjuhës angleze, studentët do të bëjnë kërkime dhe do t'i diskutojnë temat dhe materialet e marra nga Biblioteka qendrore e Bashkimit Evropian të cilat mund të gjenden në mënyrë elektronike dhe janë të hapura për të gjithë ata që dëshirojnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre lidhur me evro-integrimet.

- **Gjuhë gjermane 2**

Lënda është e koncipuar për studentët me paranjohuri të gjuhës gjermane. Në këtë kurs do të kapërcehet komunikimi i thjeshtë, kështu që pjesëmarrësit, përmes strukturave komplekse të fjalisë, do të mund të raportojnë për familjen dhe miqtë e tyre, për planet e të ardhmes dhe për të kaluarën. Ata do ta mësojnë lakimin e mbiemrave; do t'i ushtrojnë teknikat e të lexuarit dhe të dëgjimit dhe përmes ushtrimeve të veçanta fonetike do ta përmirësojnë shqiptimin si dhe do t'i shkruajnë tekstet e para koherente.

- **Gjuhë gjermane 3**

Në këtë lëndë do të sqarohen strukturat komplekse dhe kompetencat komunikuese në gjuhën gjermane. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të shprehin dëshirat dhe qëllimet e tyre dhe të pasqyrojnë sekuencat kohore. Ata do të mund të komunikojnë në situata të përditshme (si kërkimi i banesës, udhëtimi, orientimi, marrëdhëniet etj.). Objekt mësimi, gjithashtu, do të jenë edhe tekstet më të vështira për dëgjim dhe lexim. Nga tekstet autentike (artikuj gazetash, tekste të shkurtra letrare etj.) studentët do të filtrojnë informacione nga fusha e kulturës dhe civilizimit. Gjithashtu në fushën e të shkruarit do të ushtrohet edhe përpilimi i thjeshtë i llojeve të ndryshme të teksteve.

- **Gjuhë shqipe**

Përmes kësaj lënde do të sqarohen strukturat komplekse dhe kompetencat komunikative në gjuhën shqipe. Studentët do të jenë në gjendje të shprehin dëshirat dhe qëllimet e tyre dhe të pasqyrojnë sekuencat kohore. Ata do të mund të komunikojnë në situata të përditshme (si kërkimi i banesës, udhëtimi, orientimi, marrëdhëniet etj.). Objekt mësimi, gjithashtu, do të jenë edhe tekstet më të vështira për dëgjim dhe lexim. Nga tekstet autentike (artikuj gazetash, tekste të shkurtra letrare etj.) Studentët do të marrin informacione nga fusha e kulturës dhe civilizimit. Gjithashtu në fushën e të shkruarit do të ushtrohet edhe përpilimi i thjeshtë i llojeve të ndryshme të teksteve.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrimi publik përfaqëson një fushë me interes të veçantë për shkencën. Me lëndën hyrje në administrimin publik studentët marrin njohuri mbi konceptet themelore të administrimit publik. Theks i veçantë do t'i kushtohet vlerësimit të administrimit publik dhe reformave në këtë fushë në vendin tonë. Studentët do të kenë mundësi të njihen me këtë fushë dhe në mënyrë kritike të analizojnë zhvillimin dhe dukuritë në administrimin publik. Meqë kjo fushë është objekt i ndryshimeve konstante, kujdes i veçantë do t'u kushtohet teorive të reja si dhe teorive klasike të administrimit publik. Objekti i hulumtimit përbëhet nga: termet dhe njohuritë themelore lidhur me parimet dhe institucionet e administrimit publik; roli dhe rëndësia e administrimit publik në shoqërinë e organizuar; gjeneza dhe zhvillimi historik i administrimit publik; struktura organizative e administrimit publik; funksionimi i institucioneve të

administratës publike; nëpunësit civilë; kontrolli dhe përgjegjësia e administrimit publik; komunikimi në administrimin publik; administrimi publik si shërbim për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut, etj.

- **Historia e vlerave evropiane**

Qëllimi i lëndës është të analizojë gjenezën dhe zhvillimin e idesë së Evropës si një ndërtim shoqëror nga kohët e hershme e deri sot. Kursi është i dizajnuar për t'u mundësuar studentëve t'i kuptojnë idetë kryesore evropiane dhe ndikimin e tyre në shoqërinë e sotme globale, me theks të veçantë në Ballkan, për t'i aftësuar ata të mendojnë, të flasin dhe të shkruajnë për trendet bashkëkohore evropiane krahasuar me ato të kaluarat nga një perspektivë historike.

- **Sistemet politike krahasuese evropiane**

Lënda para së gjithash synon t'i njoftojë studentët me elementet kryesore të metodës krahasimtare si mënyrë për analizën e sistemeve politike. Në këtë drejtim do të bëhen krahasime të politikës dhe qeverive në Britani të Madhe, Francë, Gjermani dhe vende të tjera evropiane, me fokus të veçantë mbi kulturën politike, socializimin politik dhe zhvillimin politik. Gjithashtu do të shqyrtohen edhe sistemet politike, elektorale dhe partiake dhe çështjet kryesore ekonomike, sociale e marrëdhëniet e jashtme. Vëmendje e veçantë do t'i jepet analizimit të rëndësisë gjithnjë e më të madhe të Bashkimit Evropian mbi politikën e brendshme dhe mbi interesat kombëtare të shteteve të caktuara anëtare të BE-së.

- **Biznesi evropian**

Kjo lëndë ka qasje interdisiplinare dhe synon t'i shqyrtojë dhe t'i pasurojë njohuritë në lidhje me marrëdhëniet midis: (i) ndërmarrjeve në BE (ii) mjedisin e brendshëm institucional të BE-së, dhe (iii) ekonominë botërore. Kjo lëndë ka për qëllim t'i pasurojë njohuritë dhe të kuptuarit e faktit se si integrimi evropian dhe politikat dhe institucionet e BE-së kanë ndikuar në biznesin evropian

- **Administrata publike e BE**

Përmes kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri për tiparet themelore të administratës publike në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian. Qëllimi kryesor është hulumtimi i llojeve dhe formave të veprimtarisë së institucioneve të administratës publike në shoqëritë e ndryshme, në mënyrë që studentët të fitojnë njohuri të reja. Në këtë lëndë studentët do të njihen me rëndësinë e administratës publike në shtete të ndryshme përmes njoftimit të sistemeve të ndryshme organizative të administratës së shteteve.

- **Kultura dhe identiteti evropian**

Çdo shoqëri ka nevojë për "tjetrit" që ta ngrejë veten: Islam, shikuar historikisht, i ka luajtur një rol të rëndësishëm të "tjetrit" për Evropën. Nga beteja e Pواتjesë në shekullin e 8, kur trupat frënge e penguan ushtrinë islame që të depërtojë në viset perëndimore të Pirinejeve dhe nga apeli i Papa Urbanit II në shekullin e 11-të që u bëri identiteteve të ndryshme feudale dhe rajonale ta identifikojnë veten me atë që quhej "krishterim" që për Evropën mesjetare kishte domethënien e një komuniteti të zgjeruar, konfrontimi i traditës së krishterë dhe asaj islame e forcoi procesin e formimit të identitetit evropian. Në fakt, roli i "tjetrit", në periudha të ndryshme historike u atribuohet çifutëve, grave, heretikëve, disidentëve, dhe në fazën moderne, pas Renesansës, Ballkani, Evropa Lindore dhe regjimet komuniste morën këtë rol.